



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.585/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.07.2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Vrana Security Group” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-22446-01-28-2016, me objekt “Blerje e shërbimit të ruajtjes me roje private”, me fond limit 13,545,160 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 04.04.2016 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “International Security Albania” sh.p.k si dhe korrigjimin e ofertës ekonomike .

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k në procedurën e prokurimit të sipërpërmendur.

Skualifikimi i operatorëve ekonomikë “Nazari 2000” sh.p.k, “Vrana Security Group” sh.p.k, “International Security Albania” sh.p.k dhe bashkimi i operatorëve ekonomik Leksi Security & Pelikani në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

“Vrana Security Group” sh.p.k
Lagjia Nr. 4 Rruga “Egnatia” Durrës

“International Security Albania” sh.p.k
Blv “Zogu Parë” Pll nr. 55/1, shkalla 1, kati 2 Ap.9 Tiranë


“Nazeri 2000” sh.p.k
Rruga e Kavajës, Qendra Condor, Kulla H, Ap. 27, Tiranë

“Eurogjici Security” sh.p.k
Rruga “Adem Jashari”, Lagjia 8, H.10, Ap.3 Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Durrës
Rruga “A.Goga”, L.18, Durrës

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,



V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili i ka pranuar pjesërisht, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të

Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II. Në datën 28.01.2016 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-22446-01-28-2016, me objekt “Blerje e shërbimit të ruajtjes me roje private, me fond limit 13,545,160 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 04.04.2016 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

II.1. Në datën 04.04.2016 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.2. Në datën 19.04.2016, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Velaj	pa ofertë	I skualifikuar
- “Eurogjici Security”	1,376,068.62	I kualifikuar
- “Nazeri 2000”	1,376,068.62	I skualifikuar
- “Vrana Security Group”	1,376,068.63	I skualifikuar
- “International Security Albania”	1,376,068.63	I skualifikuar
- “Leksi Security”	1,381,886.68	I skualifikuar

II.3. Operatori Ekonomik “Vrana Security Group” sh.p.k. është njoftuar përmes sistemit të prokurimeve elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentat si më poshtë:

1. Tek mjetet e deklaruar automjeti AA 017 EX nuk ka Certifikatën e Pronësisë pra operatori ka vetëm një mjet në dispozicion nga dy të kërkuar.
2. Taksat e Bashkisë janë evazive, nuk ka vërtetim që të ketë paguar të gjithë detyrimin e vitit.
3. Oferta nuk është plotësuar për 1 (një) muaj sipas kërkesave të DST por për 9.67 muaj.

II.4. Në datën 23.04.2016, operatori ekonomik ankimues “Vrana Security Group” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës kundërshton arsyet e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.4.1 Në ankesën drejtuar autoritet kontraktor, operatori ekonomik ankimues “Vrana Security Group” sh.p.k. kundërshton vendimin e KVO-së, në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

- *Arsyeja e parë e skualifikimit se automjeti AA 017 EX nuk ka Çertifikatën e Pronësisë, shprehemi se, shoqëria ka paraqitur dokumentacionin e rregullt për 4 (katër) automjete dhe jo për 2 (dy) automjete që kërkoheshin në DST. Përkatësisht janë paraqitur automjete si më poshtë:*
 1. AA 017 EX
 2. AA 257 LL
 3. AA 157 JA
 4. AA 058 GP
- *Arsyeja e dytë e skualifikimit se taksat e Bashkisë janë evazive, pranë Autoritetit Kontraktor janë dërguar vërtetime për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2015 si dhe formularët e pagesave në bankë të komplet detyrimeve vendore.*
- *Arsyeja e tretë e skualifikimit se Auditimi i Bilanceve nuk është firmosur në çdo faqe shprehemi se, Raporti i Auditimit për të treja vitet është i firmosur dhe vulosur sipas legjislacionit të Ekspertëve Kontabël që i referohet pasqyrave dhe rezultatit të bilancit të shoqërisë.*
- *Lidhur me arsyen e katër e skualifikimit, shoqëria shprehet se janë argumentuar me analizë kostoje të detajuar çmimi për njësi për çdo muaj dhe oferta është totalisht brenda kuadrit ligjor.*
- *Së pesti kërkohet që operatorët ekonomikë Eurogjici Security dhe Nazeri 2000 të skualifikohen pasi ofertat e tyre duken qartazi që janë abuzive dhe nën minimumin ligjor. Nuk janë llogaritur si duhet shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pushimet, shpenzimet për uniformë shpenzimet për ndërlydhje dhe fitim i shoqërisë sipas legjislacionit.*
- *Së gjashti lidhur me operatorin ekonomik Eurogjici Security, Nazeri 2000 dhe International Security Albania nuk kanë vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore Durrës, Certifikatat e punonjësve të shërbimit nuk përputhen me Listpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe nuk përputhen me emrat e Listës emërore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut.*
- *Së shtati shoqëria I.S.A ka paraqitur bilance të pakonfirmuara nga tatimet.*

II.5. Në datën 29.04.2016 autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni ankimuesin lidhur me pranimin pjesërisht të ankesës sa i takon motivit të skualifikimit lidhur me mjetet dhe taksat vendore.

II.6. Në datën 03.05.2016, pala ankimuese “Vrana Security Group” sh.p.k ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Operatori Ekonomik “International Security Albania” sh.p.k. është njoftuar përmes sistemit të prokurimeve elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentat si më poshtë:

1. *Mungon certifikata për 1 roje, keni paraqitur 30 duhen 31.1. Një punonjës është pa liçencë dhe pa leje të punonjësit të certifikuar, -*
2. *Vërtetimi nga Policia Qarkut Durrës është lëshuar për 32 punonjës, ndërsa njëri është pa leje dhe certifikatë.*
3. *Oferta është për 9.67 muaj dhe jo për 1 muaj si kërkohet në DST.*
4. *Kontrata e ngjashme me “Albchrome” nuk përmban çmimin e saj.*
5. *Vërtetimi i realizimit për “Edart” është në anglisht dhe jo shqip si dhe nuk është përkthyer dhe noterizuar po ashtu nuk përmendet vlera e realizimit të kontrarës.*
6. *Artur Cuku nuk figuron në listëpagesën e sig.shoq e qershorit 2015 kur është emëruar në maj 2015 si Titullar subjekti.*

II.8. Në datën 23.04.2016, operatori ekonomik ankimues “I.S.A” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës kundërshton arsyet e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.9. Në ankesën drejtuar autoritet kontraktor, operatori ekonomik ankimues “International Security Albania” sh.p.k. kundërshton vendimin e KVO-së, në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

- *Vendimi i KVO për skualifikimin e ofertës tonë pasi mungon certifikata për 1 roje dhe për një punonjës, shprehemi se, Autoriteti i cili vërteton numrin e punonjësve të certifikuar është Drejtoria e Policisë së Qarkut. Nëpërmjet Vendimit nr. 5, datë 22.01.2016 ky Autoritet ka të certifikuar 32 punonjës shërbimi (Vërtetim i ngarkuar në sistem). Lidhur me mungesën e certifikatës së një punonjësi, shprehemi se i është transferuar dosja nga DPQ Tiranë në DPQ Durrës.*
- *Vendi i i KVO për skualifikim pasi kemi paraqitur ofertë 9.67 muaj dhe jo 1 muaj nuk qëndron pasi në Shtojcën nr. 1 te Formulari i ofertës kemi paraqitur dhe saktësuar sasinë e punonjësve të shërbimit në total, shërbimin sipas turneve, sasinë e rojeve sipas turneve, çmimin për njësi.
“International Security Albania” sh.p.k **kërkon korrigjimin e ofertës ekonomike mujore,** pasi Vlera totale që ka ofruar për të mbuluar gjithë shërbimin **për një muaj është 1,376,068.62 lekë** pa tvsh dhe jo 1,376,068.63 pa tvsh të vlerësuar nga Autoriteti.*
- *Vendi i KVO për skualifikim pasi kontrata e ngjashme nuk përmban çmimin. Ky pretendim nuk qëndron pasi bashkëlidhur me kontratën janë vendosur dhe faturat e*

shërbimit të pranuar nga blerësi (në këtë rast Albchrome), gjë e cila vërteton vlerën mujore të shërbimit.

- Vendimi i KVO për skualifikim pasi vërtetimi i realizimit për “Edart” është i pa përkthyer nuk qëndron. Pasi bashkëngjitur kontratës së shërbimit është dhe vërtetimi në Aglisht dhe në shqip i përkthyer dhe noterizuar.
- Vendimi i KVO për skualifikim pasi Z.Cuko nuk figuron në listëpagesën e sig.shoq e qershorit 2015 kur është emëruar në maj 2015 si Titullar subjekti, si në kundërshtim me ligjin dhe të pabazuar në ligj.

Tek kriteret e veçanta për kualifikim në pikën 8 është kërkuar:

“Vërtetim lëshuar nga administrata tatimore (Drejtoria Rajonale Tatimore) për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar-Dhjetor 2014, Janar- Dhjetor 2015 shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore [...] Numri mesatar I punonjësve gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2014, Janar-Dhjetor 2015 të jetë jo më I vogël se 31 punonjës shërbimi, **përfshijë administratorin dhe drejtuesin teknik.**”

Z. Cuko ka marrë certifikatën për Titullar Subjekti me datë 06.07.2015 dhe në këtë muaj është siguruar dhe janë paguar sigurimet sipas legjislacionit në fuqi, para marrjes së detyrës së Z.Cuko kjo detyrë është kryer nga paraardhësi i tij për të cilin janë bërë pagesat përkatëse.

II.10. Në datën 29.04.2016 me shkresën nr.878/2 prot, operatori ekonomik ankimues “International Security Albania” sh.p.k, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.11. Në datën 09.05.2016, pala ankimuese “I.S.A” sh.p.k ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Operatori Ekonomik “Nazari 2000” sh.p.k. është njoftuar përmes sistemit të prokurimeve elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentat si më poshtë:

1. Shoqëria ka dy fletë të ekstraktit fotokopje 14 dhe 21 të panoterizuar
2. Faqja e dytë e vërtetimit të Policisë Qarkut Durrës është fotokopje.
3. Tek faturat e “ANTA-s” mungojnë periudhat janar-shkurt, mars-prill, maj-gusht. Aneksi i kontratës ANTA është në anglisht dhe nuk specifikon që vlera e shërbimit është për një muaj apo për një vit. Duhej përkthyer dhe noterizuar.
4. Mungon vërtetimi për shlyetjen e taksave vendore për adresat e reja të hapura sipas ekstraktit historik, si psh në Elbasan lagjia Haxhias, Krujë aeroporti Nënë Tereza, Shkodër lagjia 3 Heronjtë, etj”

II.11 Në ankesën drejtuar autoritet kontraktor, operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k. kundërshton vendimin e KVO-së, në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

- *Kundërshtojmë skualifikimin e KVO lidhur me mungesat në Eksprakt, pasi në dokumentat e tenderit janë paraqitur “Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” 3 faqe, “Ekstrakti Historik Tregtar për të Dhënat e Subjektit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” me 23 faqe. Ekstrakti i QKR është dokument që lëshohet nga Institucion Shtetëror dhe ekstrakti i paraqitur përmban vulën e QKR-së. Gjithashtu ekstrakti është lehtësisht i aksesueshëm nga të gjithë.*
- *Kundërshtojmë skualifikimin e KVO për pretendimin se “faqja e dytë e Vërtetimit e Policisë së Qarkut është fotokopje” si të pabazuar dhe të padrejtë. Vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës është original dhe jo fotokopje. Autoriteti përpara skualifikimit mund të kishte kërkuar një informacion nga kjo Drejtoria mbi origjinalitetin e dokumentit të kërkuar.*
- *Kundërshtojmë skualifikimin e KVO për mungesat e fatura të ANTA për periudhën janar-shkurt, mars-prill, maj-gusht. Shoqëria “Nazeri 2000” sh.p.k në dokumentat e tenderit ka paraqitur kontratën me nr. 222/10 prot, datë 26.06.2012 me ALBCONTROL (ish ANTA) me afat 12 mujor, si dhe kontratën nr. 1058/14 prot, datë 15.11.2013 me afat 12 mujor, me vlerë 14 313 600 lek (ndërkohë që 25 % e fondit është 3 386 290 lekë). ALBCONTROLL është institucion shtetëror me 100 % capital shtetëror dhe nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është kërkuar paraqitja e faturave tatimore.*
- *Kundërshtojmë skualifikimin e KVO për mungesë të vërtetimeve për shlyerjen e taksave vendore. Nga ana e shoqërisë “Nazari 2000” janë paraqitur një sërë vërtetimesh për plotësimin e të gjitha detyrimeve e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. Sa i përket adresave të cilat janë mjete të levizshme referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, përcaktohet se : “Vendodhje e biznesit” është çdo dyqan, njësi e veçantë ose vende të tjera të palëvizshme ku kryhet biznesi”.*
- *Së pesti autoriteti duhet të skualifikojë shoqërinë Eurogjici Security pasi nuk ka përmbushur shpenzimet e detyrueshme ligjore për armatimin dhe nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton se ka në pronësi armë.*
- *Së gjashti shoqëria Eurogjici nuk ka 31 punonjës shërbimi të certifikuar dhe këto nuk janë të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar.*
- *Nuk ka shlyer të gjitha taksat vendore për vendet e ushtrimit të aktivitetit.*

II.12. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr.865/2 prot datë 29.04.2016 i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k në lidhje me pretendimet e ngritura prej tij, duke vendosur pjesërisht pranimin e ankesës. Më konkretisht, Autoriteti Kontraktues ka pranuar ankesën lidhur me ekstraktin e paraqitur nga operatori ekonomik Nazeri 2000 sh.p.k dhe faturat tatimore të ANTA.

Sa i përket ankesës së skualifikimit me asyten se Vërtetimi i Policisë të Qarkut Durrës, është fotokopje faqja e parë, Autoriteti është shprehur se për një shqyrtim të drejtë të ankesës do kërkojë në autoritetet përkatëse për vërtetësinë e dokumentit.

Autoriteti kontraktor gjithashtu me anë të shkresës nr.865/2 prot datë 29.04.2016 shprehet se ndër të tjera shoqëria “ Nazeri 2000” sh.p.k është skualifikuar pasi drejtuesi teknik që ka filluar detyrën në 06.05.2015 nuk figuron në listpagesën e këtij muaji.

II.13. Në datën 06.05.2016, pala ankimuese “Nazeri 2000” sh.p.k ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.13 Në datën 22.04.2016, pala ankimuese “Eurogjici Security” sh.p.k ka dorëzuar ankesë pranë Autoritetit kontraktor për pezullim e procedurës dhe lënien të skualifikuar të operatorëve: “Nazeri 2000” sh.p.k, “Vrana Security Group” sh.p.k, “International Security Albania” sh.p.k dhe bashkimin e operatorëve ekonomik Leksi Security & Pelikani me pretendimet si më poshtë:

Kërkojmë lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik Nazeri 2000 sh.p.k dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit :

- 1. Nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit*
- 2. Drejtuesi teknik i kësaj shoqërie z. A.Z është emëruar në QKR në datën 06.05.2015 ndërkohë ky person nuk është i siguarur në listpagesën e muajit Maj 2015.*
- 3. Vërtetimi i DPQ Durrës nuk vërteton se operatori ekonomik disponon qendër kontrolli në qytetin e Durrësit.*
- 4. Vërtetimi nr.08 datë 02.02.2016 i lëshuar nga DPQ Durrës nuk është origjinal por fotokopje e panoterizuar*
- 5. Vërtetimi për numrin e të siguarurve datë 27.04.2015 nuk është i lexueshëm pra nuk është skanuar në përputhje me udhëzimet e APP.*
- 6. Vërtetimi për numrin e të siguarurve për muajin nëntor 2015 nuk është dokument i saktë pasi nuk shpreh qartë vitin kur është lëshuar ky dokument. Dokumenti mban dy vite të ndryshme lëshimi 2015 dhe datën 01.06.2016*
- 7. Për muajin qershor 2015 nuk keni paraqitur pagesën për Tatim mbi të ardhurat personale*
- 8. Për muajin Gusht 2015 nuk keni paraqitur pagesën për Tatimin mbi të ardhurat personale*
- 9. Operatori ekonomik nuk vërteton se ka paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për listpagesën e muajit shtator 2015 pasi ka paraqitur vetëm Urdhër pagesë për sigurimet.*
- 10. Kontrata e realizuar me Antën datë 26.06.2012 është jashtë afatit 3 vjecar pasi nuk i përket 2013-2014-2015.*
- 11. Kontrata e lidhur me Antën datë 15.11.2013 është dokument i paskatë pasi faqja e parë nuk përmban numër rendor sikundër mban faqja 2 pra kemi të bëjmë me një dokument të pasaktë.*
- 12. Faturat tatimore nr.16,89,88,299,224,392,780/1,679,606,514,420 nuk janë të vulosura nga shitësi*
- 13. Certifikata e titullarit dhe drejtuesit teknik nuk përputhen me datën e Licencës së shoqërisë*

14. *Fatura 12.12.2014 lëshuar nga AKEP për pagesën e vitit 2014 nuk është origjinale dhe as njësim origjinalin por kopje. Gjithashtu nuk mban as vulën e AKEP.*
15. *Fatura 12.12.2014 lëshuar nga Raiffeisen Bank për pagesën e vitit 2014 është kopje e panoterizuar si dhe nuk është e vulosur nga Banka.*
16. *Fatura 09.06.2014 lëshuar nga AKEP për pagesën e vitit 2014 nuk mban vulën e AKEP.*
17. *Fatura 27.03.2015 lëshuar nga AKEP për pagesën e vitit 2015 nuk mban as firmë as vulë e AKEPIT.*
18. *Dokumenti datë 28.04.2014 është një dokument i paraqitur në gjuhë të huaj i papërkthyer në gjuhën shqipe.*
19. *Certifikata e mjetit me targa AA249IE i përket I. A dhe jo shoqërisë Nazeri 2000.*

II.14 Autoriteti Kontraktor me shkresën nr.853/2 prot datë 29.04.2016 i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Eurogjici Security” sh.p.k në lidhje me pretendimet e ngritura prej tij. Autoriteti është shprehur se duke marrë në konsideratë vlerësimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shoqëria “Eurogjici Security” sh.p.k është kualifikuar dhe bazuar në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 409/2015 datë 19.06.2015 ku citohet se “operatori ekonomik nuk legjitimohet për tu ankuar për operatorët e tjerë”, në këtë rast shoqëria “Eurogjici Security” sh.p.k paraqitur si bashkim operatorësh nuk është dëmtuar nga vendimi i Autoritetit Kontraktor.

II.15 Në datën 09.05.2016 operatori ekonomik ankimues “Eurogjici Security” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Vrana Security Group” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se “Oferta nuk është plotësuar për 1 (një) muaj sipas kërkesave të DST por për 9.67 muaj, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi parashikohet se:

- *Shënim: Operoret ekonomik duhet të paraqesin oferta ekonomike, bazuar ne koston mujore te kryerjes së shërbimit te ruajtjes me roje .*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar Formularin e Ofertës së bashku me analizën e detajuar të kostos për një roje në muaj. Akoma më tej Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor në klasifikimin përfundimtar ka kuotuar operatorin ekonomik ankimues në sistemin e prokurimeve elektronike bazuar në vlerën e ofertës mujore dhe jo totale në përputhje me kriterin e përcaktuar sa më lart cka do të thotë se nuk është krijuar asnjë konfuzion lidhur me mënyrën e ofertimit nga operatorët ekonomikë duke vënë kështu vetë autoriteti kontraktor në kushte barazie ofertuesit. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se oferimi në total në rastin konkret nuk e bën ofertën ekonomike të operatorit ekonomik ankimues të pavlefshme dhe rrjedhimisht skualifikimi i tij nga procedura e prokurimit nuk gjendet e bazuar.

Sa më sipër prendimi i ankimuesve qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “International Security Albania” sh.p.k për “Vertetimi nga Policia Qarkut Durrës është lëshuar për 32 punonjës, ndërsa njëri është pa leje dhe certifikatë” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën ekstra të publikuar nga autoriteti kontraktor më datë 10.03.2016 në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet se:

- Vertetim lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, ku te jepet informacion për numrin e punonjësve të certifikuar konform ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", shoqëruar me certifikatat/lejet e punonjësve të certifikuar jo më pak se 31, disponimin e salles operative, grupit te gatshem(Sipas shkresës 759/1 dt.24.04.2015 të Drejtorisë të Qarkut Durrës)

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “International Security Albania” sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Certifikatë nr. __ datë __. __. 2014; Certifikatë Nr.0945 datë 27.06.2014; Certifikatë nr.1053 datë 29.10.2014; Certifikatë nr.0465 datë 30.11.2011; Certifikatë nr.0636 datë 29.03.2013, Certifikatë nr.0757 datë 03.02.2014; Certifikatë nr.0982 datë 25.07.2014, Certifikatë nr.0590 datë 29.04.2013, Certifikatë nr.0466 datë 30.11.2011, Certifikatë nr.0981 datë 25.07.2014, Certifikatë nr. 0636 datë 29.03.2013, Certifikatë nr.0181 datë 02.11.2010, Certifikatë nr. 0184 datë 02.11.2010, Certifikatë nr.0754 datë 03.02.2014, Certifikatë nr.0187 datë 02.11.2010, Certifikatë nr. 0720 datë 16.01.2014, Certifikatë nr.0597 datë 29.04.2013, Certifikatë 0578 datë __. __. 2011, Certifikatë nr.0592 datë 29.04.2013, Certifikatë nr.0593 datë 29.04.2013, Certifikatë nr.0598 datë 29.04.2013, Certifikatë nr.1018 datë 08.09.2014, Certifikatë nr.1136 datë 20.03.2015, Certifikatë nr.0763 datë 03.02.2014, Certifikatë nr.5946 datë 30.06.2014, Certifikatë nr. __ datë __. __. 2014, Certifikatë nr/0553 datë 08.06.2012, Certifikatë nr.1046 datë 29.10.2014, Certifikatë nr.1055 datë 29.10.2014, Certifikatë nr.1080 datë 26.11.2014, Certifikatë nr.0171 datë 02.11.2010, Certifikatë nr.0109 datë 25.06.2010, Certifikatë nr.0519 datë 16.02.2012,

III.2.3. Neni 5 “Certifikimi” i Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikon shprehimisht se: 1. *Certifikimi i titullarit dhe i drejtuesit teknik të SHPSF-së është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.* 2. *Certifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut.* 3. *Vendimet e certifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohen duke u bazuar respektivisht në mendimin paraprak të KSHKCL-së dhe KSHKC-së.* 4. *Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa për punonjësën e shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të formularit të kërkesës për aplikim.* 5. *Certifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje, për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësën e shërbimit.*

III.2.4. Sa më sipër konstatuar Komisioni vlerëson se operatori ekonomik “International security Albania” nuk ka mundur të paraqesë dokumentacion të vlefshëm për të gjithë punonjësit e shërbimit të kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Vetëm 24 prej certifikatave të paraqitura nga ankimuesi janë të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar të përcaktuar në ligj ndërsa certifikatat e tjera të punonjësve nuk janë të vlefshme për arsye se data e lëshimit të tyre i përket viteve 2010 dhe 2011 pra jashtë afatit të vlefshmërisë.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]*”.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “International Security Albania” sh.p.k nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se *Faqja e dytë e vërtetimit të Policisë Qarkut Durrës është fotokopje si dhe Mungon vërtetimi për shlyerjen e taksave vendore për adresat e reja të hapura sipas ekstraktit historik, si psh në Elbasan lagjia Haxhias, Krujë aeroporti Nënë Tereza, Shkodër lagjia 3 Heronjtë, etj*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se këto motive skualifikimi janë dhënë vetëm nga njëri prej anëtarëve të KVO duke mos përbërë në këtë rast arsye skualifikimi për operatorin ekonomik ankimues. Lidhur me dy arsyet e tjera përkatësisht për Ekstraktin e QKR dhe Faturave Tatimore të Antës janë pranuar nga autoriteti kontraktor si të rregullta pas ankimit të paraqitur nga operatori ekonomik pranë këtij të fundit.

Sa më sipër Komisioni gjykon se ankesa lidhur me motivet e skualifikimit të operatorit ekonomik Nazeri 2000 sh.p.k nuk ka objekt e rjedhimisht Komisioni nuk shprehet në lidhje me to.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Eurogjici Security” me arsyetimin se “*nuk ka 31 punonjës shërbimi të certifikuar dhe këto nuk janë të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën ekstra të publikuar nga autoriteti kontraktor më datë 10.03.2016 në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet se:

- *Vertetim lëshuar nga Drejtorja e Policisë së Qarkut Durrës, ku te jepet informacion për numrin e punonjësve të certifikuar konform ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", shoqëruar me certifikatat/lejet e punonjësve të certifikuar jo më pak se 31, disponimin e salles operative, grupit te gatshem(Sipas shkresës 759/1 dt.24.04.2015 të Drejtorisë të Qarkut Durrës)*

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Certifikatë Nr.0790 datë 26.02.2014; Certifikatë Nr.0327 datë 10.09.2011, Certifikatë Nr.0549 datë 08.06.2012, Certifikatë Nr.0328 datë 10.03.2011; Certifikatë nr.0117 datë 25.06.2010, Certifikatë nr.0178 datë 02.11.2010; Certifikatë Nr.0333 datë 29.04.2011; Certifikatë Nr.0874 datë 23.05.2014; Certifikatë Nr. 0946 datë 27.06.2014, Certifikatë nr. 0873 datë 23.05.2014, Certifikatë Nr.1023 datë 03.10.2014, Certifikatë Nr.0662 datë 30.06.2013, Certifikatë Nr.1146 datë 16.04.2015, Certifikatë nr.0508 datë 14.02.2012, Certifikatë nr.1075 datë 26.11.2014, Certifikatë nr.0508 datë 14.02.2012,

Certifikatë nr.0601 datë 29.04.2013, Certifikatë nr.0670 datë 30.06.2013, Certifikatë nr.1157 datë 16.04.2015, Certifikatë nr.1039 datë 03.10.2014, Certifikatë nr.1039 datë 03.10.2014, Certifikatë nr.0107 datë 25.06.2010, Certifikatë nr.0197 datë 02.11.2010, Certifikatë nr.0753 datë 03.02.2014, Certifikatë nr.0113 datë 25.06.2010, Certifikatë nr.0176 datë 02.11.2010, Certifikatë nr.0522 datë 16.02.2012, Certifikatë nr.0572 datë 08.06.2012, Certifikatë nr.1109 datë 26.12.2014, Certifikatë nr.0174 datë 02.11.2010, Certifikatë nr.0661 datë 30.06.2013, Certifikatë nr.0754 datë 03.02.2014, Certifikatë nr.0192 datë 02.11.2010, Certifikatë nr.0069 datë 03.05.2010, Certifikatë nr.0463 datë 30.11.2011, Certifikatë nr.0309 datë 04.02.2011, Certifikatë nr.0479 datë 31.01.2012, Certifikatë nr.0107 datë 25.06.2010, Certifikatë nr.0996 datë 25.06.2014, Certifikatë nr.0508 datë 14.02.2012.

III.4.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti*

kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..”*

III.4.4. Neni 5 “Certifikimi” i Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikon shprehimisht se: *1. Certifikimi i titullarit dhe i drejtuesit teknik të SHPSF-së është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. 2. Certifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut. 3. Vendimet e certifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohen duke u bazuar respektivisht në mendimin paraprak të KSHKCL-së dhe KSHKC-së. 4. Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa për punonjësën e shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të formularit të kërkesës për aplikim. 5. Certifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje, për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësën e shërbimit.*

III.4.5. Sa më sipër konstatuar Komisioni vlerëson se operatori ekonomik “Eurogjici Security” nuk ka mundur të paraqesë dokumentacion të vlefshëm për të gjithë punonjësit e shërbimit të kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Vetëm 21 prej certifikatave të paraqitura nga ankimuesi janë të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar të përcaktuar në ligj ndërsa certifikatat e tjera të punonjësve nuk janë të vlefshme për arsye se data e lëshimit të tyre i përket viteve 2009,2010 dhe 2011 pra jashtë afatit të vlefshmërisë.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: *“[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”*.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Eurogjici Security” sh.p.k për shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k me arsyetimin se *“Nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit”*, Komisioni i prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Ligjor i Operatorëve Ekonomikë” të dokumentave të tenderit të procedurës objekt ankimi përcaktohet :

- *Nje dokument qe verteton se (subjekti juaj) i ka plotesuar te gjithas detyrimet e taksave dhe tarifave vendore leshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike,cdo anetar i grupit duhet te dorezoje kete dokument).*

III.5.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Vërtetim Nr.ska datë 02.10.2015 lëshuar nga Bashkia Kurbin për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2015.*
- *Vërtetim nr.149 prot datë 21.09.2015 Bashkia Gjirokastrë për vitin 2015*
- *Vërtetim Nr.1842 Prot datë 15.10.2015 Bashkia Kukës për vitin 2015*
- *Vërtetim Nr.2437 Prot datë 13.08.2015 Bashkia Korçë për vitin 2015*
- *Vërtetim datë 23.09.2015 Bashkia Berat për vitin 2015*
- *Vërtetim Nr.17 prot datë 09.10.2015 Bashkia Elbasan për vitin 2015*
- *Vërtetim Nr.4555 prot datë 22.09.2015 Bashkia Fier për vitin 2015*
- *Vërtetim Nr.31 prot datë 24.03.2016 Bashkia Fier për vitin 2016*
- *Vërtetim datë 02.03.2016 Bashkia Berat për Vitin 2016*
- *Vërtetim Nr.87 prot datë 07.03.2016 Bashkia Shkodër për vitin 2016*
- *Vërtetim Nr.657 prot datë 07.03.2016 Bashkia Kukës për vitin 2016*
- *Vërtetim Nr.344 prot datë 15.03.2016 Bashkia Tiranë për vitin 2016*
- *Vërtetim Nr.291 Prot datë 11.03.2016 Bashkia Gjirokastrë për vitin 2016*
- *Vërtetim nr.774 prot datë 03.02.2016 Bashkia Vlorë për vitin 2015 dhe 2016*
- *Vërtetim Nr.20 prot datë 11.05.2015 Bashkia Sarandë për vitin 2015*
- *Vërtetim nr.25/6 prot datë 25.06.2012 Bashkia Elbasan për vitin 2012*
- *Vërtetim nr.12 prot datë 29.01.2016 Bashkia Elbasan për vitin 2015 dhe 2016*
- *Vërtetim nr,ekstra datë 02.02.2016 Bashkia Kurbin për vitin 2016*
- *Vërtetim nr.367 datë 12.03.2015 Bashkia Tiranë për vitin 2015*
- *Vërtetim nr.753 datë 25.04.2014 Bashkia Tiranë për vitin 2014*
- *Vërtetim nr.723 datë 16.04.2013 Bashkia Tiranë viti 2013*
- *Vërtetim nr.774 datë 03.02.2016 Bashkia Vlorë për vitin 2015 dhe 2016*
- *Vërtetim datë 13.07.2015 Bashkia Kavajë deri më 24.02.2015.*
- *Vërtetim datë 23.09.2015 Bashkia Berat për vitin 2015*
- *Vërtetim nr.17 prot datë 09.10.2015 Bashkia Elbasan për vitin 2015*
- *Vërtetim nr.4555 datë 22.09.2015 Bashkia Fier për vitin 2015*
- *Vërtetim nr.1842 prot datë 15.10.2015 Bashkia Kukës për vitin 2015*
- *Vërtetim nr.datë 02.10.2015 Bashkia Kurbin për vitin 2015*
- *Vërtetim nr.444 datë 13.10.2015 Bashkia Shkodër për vitin 2014 dhe 2015*
- *Vërtetim datë 20.10.2015 Bashkia Dibër për vitin 2015*
- *Vërtetim nr.214 prot datë 25.09.2015 Bashkia Vlorë për vitin 2015*
- *Vërtetim datë 09.12.2015 Bashkia Librazhd për vitin 2015*
- *Vërtetim nr.2507 prot datë 31.03.2016 Bashkia Vlorë për vitin 2015 dhe 2016*

- Vërtetim datë 09.12.2015 Bashkia Krujë
- Vërtetim nr.1338 prot datë 24.03.2016 Bashkia Korçë për vitin 2016

III.5.3. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit sa më sipër, si dhe verifikimit të të dhënave të subjektit në Ekstraktin Historik të QKR konstaton se zyra qendrore e shoqërisë “Nazeri 2000” sh.p.k është Tiranë ndërsa në seksionin 15 “Vënde të tjera të ushtrimit të aktivitetit” të Ekstraktit Historik të QKR rezulton se operatori ekonomik ankimues ushtron aktivitetet përkatësisht edhe në Kukës, Dibër, Vlorë, Berat, Tiranë, Elbasan, Korçë, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Berat, Shkodër.

Akoma më tej Komisioni verifikoi të gjitha ndryshimet në të dhënat e regjistruara të pasqyruara në mënyrë kronologjike në Ekstraktin Historik të subjektit “Nazeri 2000” sh.p.k dhe konstatoi se gjatë vitit 2015 kanë ndodhur ndryshime në adresat e aktivitetit të shoqërisë “Nazeri 2000” sh.p.k, duke u shtuar adresat në Lezhë, Gjirokastrë, Shkodër, Berat, Kukës, Dibër, Fier, Vlorë, Korçë, Elbasan, Shkodër, Kukës.

III.5.4. Neni 12 “Rregjistrimi dhe Liçensimi” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: *Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.*

Sa më sipër Komisioni konstatoi se operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacion të rifreskuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj Bashkisë Korçë për vitin 2015 pasi referuar ekstraktit historik të operatorit ekonomik rezulton se adresa e re në qytetin e Korçës është hapur më datë 08.09.2015 ndërkohë vërtetimi i takon datës 13.08.2015. Në këto kushte ankimuesi kishte detyrimin ligjor të paraqeste në tender vërtetim të rifreskuar për shlyerjen e detyrimeve vendore për këtë bashki, kërkesë e cila nuk është përmbushur nga operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Eurogjici Security” sh.p.k., mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjyqimit mësipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesit.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Vrana Security Group” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-22446-01-28-2016, me objekt “*Blerje e shërbimit të ruajtjes me roje private*”, me fond limit 13,545,160 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 04.04.2016 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “International Security Albania” sh.p.k , “Eurogjici Security” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Vrana Security Group” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
5. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Vrana Security Group” sh.p.k.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1058 Prot; Datë 03.05.2016
Nr. 1100 Prot; Datë 06.05.2016

Nr. 1111 Prot; Datë 09.05.2016
Nr. 1109 Prot; Datë 09.05.2016

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Juliana Hoxha

Anëtar
Leonard Gremshi

Kryetar
Gentian Këri

Mendim Kundër

I.Unë, anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik, Juliana Hoxha jam pjesërisht dakord me arsyetimin dhe dispozitivin e vendimit në lidhje me ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k, “ International Security Albania” sh.p.k, “Vrana Security Group” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-22446-01-28-2016, me objekt “*Blerje e shërbimit të ruajtjes me roje private*”, me fond limit 13,545,160 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 04.04.2016 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

Pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

I. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Vrana Security Group” sh.p.k dhe “International Security Albania” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se “*Taksat e Bashkisë janë evazive, nuk ka vërtetim që të ketë paguar të gjithë detyrimin e vitit*”, vërej se se ky motiv është pranuar nga autoriteti kontraktor si i përmbshur pas ankimit të paraqitur nga operatori ekonomik pranë këtij të fundit. Megjithatë pas verifikimit në sistemin e prokurimeve elektronike konstatoj se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është bërë rivlerësim në sistem lidhur me arsyen e skualifikimit duke rezultuar ende ankimuesi i skualifikuar edhe për këtë arsye. Në këo kushte vlerësoj të shqyrtoj këtë pretendim e operatorit ekonomik ankimues pasi gjykoj se autoriteti kontraktor duhej të kishte kryer rivlerësimin në sistemin e prokurimeve elektronike duke pasqyruar në të motivet përfundimtare të skualifikimit për operatorët ekonomik.

I.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi parashikohet se:

I.1.2. *Nje dokument qe verteton se (subjekti juaj) i ka plotesuar te gjithas detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike,cdo anetar i grupit duhet te dorezoje kete dokument).*

I.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim Nr. 22 Prot datë 05.03.2015 lëshuar nga Bashkia Durrës për shlyerjen e taksave vendore me anë të të cilit vërtetohet se subjekti “Vrana Security Group” sh.p.k nuk ka detyrime të palikuiduara deri në datën e marrjes së vërtetimit.
- Akt Detyrimi për Taksat dhe Tarifat Vendore lëshuar nga Bashkia Vorë.

I.1.4. Referuar Ektraktit të Rregjistrimit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit konstatohet se operatori ekonomik “Vrana Security Group” sh.p.k ka vend të ushtrimit të aktivitetit në

Bashkinë Vorë dhe Bashkinë Durrës. Ndërkohë që për Bashkinë Durrës ankimesi ka paraqitur vërtetimin lëshuar nga kjo e fundit për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2015 nuk ka paraqitur të njëjtin dokumentacion edhe lidhur me Bashkinë Vorë. Akt Detyrimi i lëshuar nga bashkia Vorë është një pasqyrë e detyrimit financiar të operatorit ekonomik i cili në vetvete nuk provon shlyerjen e taksave vendore për këtë Bashki.

Sa më sipër Konstatuar, gjykoj se operatori ekonomik ankimues ka dështuar në përmbushjen e kriterit për shlyerjen e taksave vendore për Bashkinë Vorë pasi nuk ka provuar me anë të dokumentacionit konkret shlyerjen e të gjitha taksave vendore në këtë Bashki ku ushtron aktivitetin e tij.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

I.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Shoqëria ka dy fletë të ekstraktit fotokopje 14 dhe 21 të panoterizuar*”, *Tek faturat e “ANTA-s” mungojnë periudhat janar-shkurt, mars-prill, maj-gusht si dhe Aneksi i kontratës ANTA është në anglisht dhe nuk specifikon që vlera e shërbimit është për një muaj apo për një vit. Duhej përkthyer dhe noterizuar*”, vërej se këto motive janë pranuar nga autoriteti kontraktor si të rregullta pas ankimit të paraqitur nga operatori ekonomik pranë këtij të fundit. Megjithatë pas verifikimit në sistemin e prokurimeve elektronike konstatoj se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është bërë rivlerësim në sistem lidhur me këto arsye skualifikimi duke rezultuar ende ankimuesi i skualifikuar edhe për këto arsye. Në këto kushte vlerësoj të shqyrtoj pretendimet sa më sipër të ngritura nga operatori ekonomik ankimues pasi gjykoj se autoriteti kontraktor duhej të kishte kryer rivlerësimin në sistemin e prokurimeve elektronike duke pasqyruar në të motivet përfundimtare të skualifikimit për operatorët ekonomik.

I.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Përgjithshme të Pranim Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit të Regjistrit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 8 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

I.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstrakt Historik lëshuar nga Qendra Kombëtare e Rregjistrimit e noterizuar.

I.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues konstatoj se faqja 14 dhe 21 e ekstraktit nuk përmban vulën e noterit megjithatë e gjej të pabazuar arsyen e skualifikimit.

Ekstrakti është një dokument lehtësisht i verifikueshëm në në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit i cili lejon çdo person të interesuar të aksesojë dhe të verifikojë çdo dyshim në lidhje me të. Në këtë kuptim gjykoj se dokumentacioni i paraqitur është tërësisht i vlefshëm në përputhje me kriterin e vecantë të kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

I.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se *“Tek faturat e “ANTA-s” mungojnë periudhat janar-shkurt, mars-prill, maj-gusht. Aneksi i kontratës ANTA është në anglisht dhe nuk specifikon që vlera e shërbimit është për një muaj apo për një vit. Duhej përkthyer dhe noterizuar, vërej se,*

I.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të tenderit të procedurës përcaktohet :

Sherbime të meparshme të ngjashme në një vlerë sa 25 % të fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit (2013, 2014, 2015) të marra së bashku.

- *Kur shërbimi i ngjashëm është i realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e realizimit të lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate. ose*
- *Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private. Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën e lidhur me subjektet private të shoqëruar me faturën përkatëse tatimore të shitjes.*

I.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacion si më poshtë:

- Kontratë Shërbimi Nr.222/10 Prot datë 26.06.2012 lidhur ndërmjet Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror sh.a dhe shoqërisë “Nazeri 2000” sh.p.k.
- Vërtetim Realizimi Nr.868 datë 24.11.2014
- Fatura Tatimore Shitje Gusht 2013-Shator 2014.

I.3.3. Sa më sipër gjykoj se operatori ekonomik ankimues me anë të dokumentacionit të paraqitur ka përmbushur kriterin e sipërcituar duke vërtetuar se ka realizuar kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit. Akoma më tej ankimuesi ka paraqitur dokumentacionin që provon përmbushjen e kriterit, Kontratë, Vërtetim Realizimi si dhe Fatura Tatimore të Shitjes të cilat provojnë eksperiencën e ngjashme të operatorit ekonomik në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Përfundimisht vlerësoj se Komisioni i Prokurimit Publik duhej të shprehej për skualifikimin edhe të operatorit ekonomik “Vrana Security Group” sh.p.k në kushtet kur konstatohet mospërmbushja e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Anëtare

Juliana Hoxha

